

Hyrje

Përligjja e përzgjedhjes së temës

Përschendetjet dhe urimet paraqesin formulat më konvencionale të ligjërimit dhe përfshihen në kuadrin e mirësjelljes apo kortezisë gjuhësore. Teoritë ekzistuese rreth konceptit të mirësjelljes gjuhësore (it.cortesia linguistica) kanë qenë formuluar nga sociologë dhe antropologë të cilët kanë tërhequr vëmendjen rreth faktit se, në të gjitha shoqëritë dhe epokat, janë të pranishme shprehje dhe formula verbale, që kanë për qëllim t'i minimizojnë rreziqet ndërveprimit verbal dhe të mbajnë ekuilibrin dhe rendin shoqëror. Studimi i mirësjelljes është kështu i përfshirë në rrymën teorike të pragmatikës, që mbështetet edhe nga disiplina të tjera, si gjuhësia, filozofia e gjuhës, sociologjia dhe antropologjia. Disiplina të tilla i ofrojnë pragmatikës hapësirat për ta zbatuar më mirë objektivin e analizës së saj. Tema, që do të trajtohet në këtë studim, përbëhet pikërisht nga përschendetjet dhe urimet në shqipen dhe në italishten, të analizuar në këndvështrimin sociolinguistik. Synimi është që, fillimisht, të japim një kuadër të përgjithshëm rreth konceptit të mirësjelljes gjuhësore apo kortezisë linguistike nga pikëpamja teorike, për të kaluar pastaj në analizën e përschendetjeve dhe urimeve, në mënyrë të veçantë formulave të mirësjelljes, të cilat në tërësi kanë funksionin e të shprehurit të një mesazhi (një përmbajtjeje, ndjenje respekti, simpatie, falënderim, mirënjohje etj), në një situatë të caktuar ku ndihet nevoja për të shprehur diçka: qëllimi i tyre pra është lehtësimi pikërisht sepse bëhet fjalë për fraza të parapërgatitura të shkëmbimit me fjalë.

Nuk janë të pakta studimet kontrastive të realizuara ndërmjet dy a më shumë gjuhëve të ndryshme në kuadrin e mirësjelljes gjuhësore, porse, megjithatë, duket se mungon deri sot një studim i drejtpërdrejtë midis dy gjuhëve kaq të ndryshme, si shqipja dhe italishtja, ndonëse i përkasin të dyja familjes së gjuhëve indoeuropiane.

Shprehim bindjen se kjo mënyrë trajtimi ka vlerë studimore e shkencore në kuadrin e dygjuhësisë, po ka edhe vlera konkrete për thellimin e njohjes së italishtes nga ana e shqiptarëve, po edhe të shqipes nga ana e jo pak italianëve, që kanë gjithmonë e më shumë interesa për Shqipërinë dhe shqiptarët. Me shumë vlerë, besojmë, janë shqyrtimet e tilla për përkthyesit dhe mësimdhënësit e italishtes, po edhe për mediat e shkruara e të folura, që kanë të bëjnë edhe "on-line" më lajme, që i marrin drjepërdrejt nga mediat e agjencitë e lajmeve italiane.

Na u duk, pra, me shumë interes të mund të sillnim një kontribut të ri dhe, besojmë të jetë një gjë interesante, në këtë pikëpamje.

Me këtë studim, sadoqë modest, shpresojmë të kemi sjellë një ndihmesë të re rreth mirësjelljes gjuhësore, duke hedhur dritë mbi dallimet socio-kulturale midis dy gjuhëve: italishtes dhe shqipes.

Objekti, karakteri dhe synimet e punimit

Mirësjellja gjuhësore ka ekzistuar në çdo vend dhe në çdo gjuhë, sepse ajo ka qenë dhe mbetet shprehje e traditave kulturore dhe lidhet ngushtë me organizimin politik e shoqëror dhe me zakonet dhe traditat e çdo vendi a kombi. Gjuha e një kombi, siç dihet, është e lidhur ngushtë me karakterin e popullit ose të bashkësisë shoqërore përkatëse, që është djepi i saj dhe, madje, sado që mund të duket e diskutueshme, ndoshta edhe disi e çuditshme, është e vërtetë se ashtu si gjuha zbulon dhe tregon karakterin e një kombi, ashtu edhe cilësitë dhe virtytet e çdo populli duken nga etnografia e të folurit të tij.

Mirësjellja apo kortesia shfaqet në forma të ndryshme në epoka të ndryshme dhe në kultura të ndryshme, prandaj, pavarësisht se ekzistojnë parime të përgjithshme, ka edhe një sasi të madhe shprehjesh të larmishme e të dallueshme. Mbi bazën e kësaj hipoteze-bazë nisim analiza e këtij studimi. Objektivi i këtij punimi është, pra, të analizojmë formulat e përshëndetjes dhe urimet në mënyrë përplasëse (kontrastive) ndërmejt dy gjuhëve: italishtes dhe shqipese, me qëllim që të verifikohet se, në çfarë mënyre dhe në çfarë mase, dy gjuhë kaq të ndryshme mund të kenë aq pika të përbashkëta si dhe dallime e ndryshme lidhur pikërisht me formulat e mirësjelljes më konvencionale: përshëndetjeve dhe urimeve.

Materialet për krahasim mbështeten në gjuhët standarde, edhe pse nuk do të mungojnë edhe të dhëna a referime sporadike nga format dialektale më të njohura, por pa e shpërndarë vëmendjen në shumë burime, qofshin edhe interesante, duke synuar kështu të ofrojmë një analizë sa më objektive dhe homogjene.

Të dhënat mbi të cilat mbështetet analiza e këtij studimi, në pjesën më të madhe përbëhen nga fusha e ndërveprimit verbal, që kryhet sy për sy (it. faccia a faccia) përderisa paraqesin varietete më komplete dhe më significative për të pasur mundësi të ndërmerreshin edhe analiza të kësaj tipologjie. Megjithatë, nuk kanë munguar edhe të dhëna nga gjuha e shkruar, si nga shkëmbimet a letërkëmbimet (epistolari), qofshin ato të natyrës formale ose të natyrës informale, po janë marrë në analizë edhe formulat e përshëndetjes nga gjuha e përditshme, që dalin tashmë edhe në mjetet e komunikimit masiv (e-mail, sms, spote televizive, afishime, reklama etj.); janë marrë shembuj edhe nga letërsia artistike në të dy gjuhët.

Natyrisht, nuk pretendojmë se ky punim të jetë shterues nga të gjitha pikëpamjet, kjo edhe për arsyen se, qysh në ideimin e tij, janë përcaktuar edhe a priori disa caqe a kufizime të kërkimit, duke synuar ta përqëndronim vëmendjen kryesisht mbi disa pika më të rëndësishme të dukurisë (përdorimi i gjuhës standarde dhe komunikimi kryesisht verbal) prandaj, jemi të vetëdijshëm se nuk mungojnë edhe pikat, që mbeten për t'u thelluar më tej lidhur me temën e mirësjelljes a kortezisë gjuhësore, duke e parë atë edhe në këndvështrime të tjera në të ardhshmen.

Metodologjia dhe struktura e punimit

Ky studim i bazuar mbi analizën përplasëse (kontrastive) të përshëndetjeve dhe urimeve në shqipen dhe në italishten, ashtu si përgjithësisht studime të këtij tipi, është hartuar duke ndjekur tipologjinë e metodës përplasëse-krahasuese.

Fillimisht është synuar të jepet një inkuadrim teorik i tematikës së këtij studimi në lidhje me konceptin e mirësjelljes a kortezisë duke marrë në konsideratë teoritë e gjysmës së dytë të shekullit nënëntëmbëdhjetë e duke ardhur deri te ato më të rejat e të dhjetëvjeçarëve të fundit. Në vijim është kaluar në analizën e mjeteve me të cilat shprehet mirëfilli mirësjellja gjuhësore (it. cortesia linguistica). Mjete të tilla mund të nyjëtohen në katër drejtime kryesore: a) përshëndetjet, b) urimet, c) mirësjellja e shprehur me mjete leksikore, d) mirësjellja e shprehur me mjete gramatikore. Na u duk interesante që, megjithatë, t'i kushtonim një kapitull edhe mirësjelljes tekstore (it. cortesia testuale), dhe jo vetëm asaj verbale, duke u dhënë vëmendje të posaçme sidomos kompetencave që duhet të ketë përkthyesi në momentin që duhet të jetë në gjendje të njohë strategjitë dhe formulat e mirësjelljes të përdorura në tekstin fillestar në gjuhën nisëse, dhe t'i përkthejë funksionet dhe objektivat e tij në një gjuhë të huaj, me të tjera strategji në gjuhën mbërritëse. Për lehtësi konsultimi menduam të përfshijmë në studimin e pranishëm një tabelë përmbledhëse kontrastive të përshëndetjeve dhe urimeve në dy gjuhë, duke përmbledhur aty edhe formula të tjera të mirësjelljes, esenciale në shkëmbimet tona verbale të përditshme, si ndjesa dhe falenderimet, të cilat, përndryshe do të mbeteshin jashtë këtij studimi. Si shtojcë, është përpunuar edhe një fjalorth, që përmbledh të gjitha emërtimet e

mirësjelljes a kortezisë, epitetet e përdorshme në mjedisin familiar dhe profesional, si edhe përshëndetjet dhe urimet e cituara në këtë studim, të cilat janë dhënë, së pari, në shqip dhe kanë krahas përkthimin në italishten.

Kreu i parë u kushtohet teorive të pesëdhjetë viteve të fundit mbi konceptin e mirësjelljes. Fillimisht përcaktohet se në se konsiston ligjërimi i mirësjelljes a kortezisë, ose ai ligjërim i përbërë nga strategji, norma dhe konvencione verbale, të përdoruara nga një bashkësi folëse për ta përmbajtur konfliktualitetin dhe për të favorizuar harmoninë në ndërveprimin komunikativ.

Pjesa më e madhe e kërkimeve ndahen në dy orientime teorike të kundërvëna: drejtimi i parë nisët nga kundrimi pragmalinguistik, kurse tjetri nga perspektiva sociologjike. Drejtimi i parë (që quhet edhe teoria e brezit të parë) përfaqësohet nga modeli i Brown-it e Levinson-it (1978) dhe ka në bazë parimin e kooperimit të Grice-s (1975) dhe konceptin e “faqes” të Goffman-it (1967) rregulla që qëndrojnë në bazën e realizimeve gjuhësore të ndryshme të mirësjelljes në kultura të ndryshme. Drejtimi i dytë e konteston modelin e Brown-it e Levinson-it, duke u nisur nga presupozimi se studimi i ligjërimin të mirësjelljes është dinamik, duke marrë parasysh heterogjenitetin e faktorëve shoqërorë dhe individualë që pleksen në të. Drejtimi i parë, pra, ofron një vizion universalistik në bazë të të cilit mirësjellja konceptohet në të njëjtën mënyrë në të gjitha gjuhët dhe në të gjitha kulturat e ndryshme dhe mënyra e ndryshme për t’i formuluar ato do të pasqyrojnë divergjencat në strukturë që përbëjnë gjuhë të ndryshme, kurse drejtimi i dytë përkrah një vizion relativistik, duke vështruar në diferencat e strategjive gjuhësore refleksin e një konceptimi të ndryshëm të mirësjelljes në kultura të ndryshme. Mirësjellja, pra, është universale përderisa të gjitha shoqritë kanë të përbashkëta sjellje që lejojnë të mbajnë harmoninë midis folësve, por edhe, në të njëjtën kohë, nuk është, përderisa format e realizimit variojnë, qoftë edhe sadopak, nga një shoqëri në tjetrën.

Në **kreun e dytë** trajtohen përshëndetjet si formula të mirësjelljes konvencionale. Në sythin hyrës shpjegohet koncepti i formulës. Formulatat në tërësi kanë funksionin e të të shprehurit të një mesazhi (një përmbajtjeje, ndjenjë respekti, simpatie, falënderim, mirënjohje etj.), në një situatë të caktuar, ku ndihet nevoja për të shprehur diçka: qëllimi i tyre, pra, është lehtësimi pikërisht sepse bëhet fjalë për fraza të parapërgatitura të shkëmbimit me fjalë. Në vijim janë ilustruar funksioni i formulave të përshëndetjes, të cilat kanë vlerën e simboleve që, mbi bazën e një konvencionit, rregullojnë marrëdhëniet shoqërore midis folësve, duke hapur e mbyllur tipa të ndryshëm shkëmbimesh komunikative me përdorimin simultan të disa kodeve, si ai verbal, gjestual dhe prosemik. Përshëndetjet hapëse ose hyrëse, përveç shprehjes së dëshirës për të shfaqur simpati kundrejt marrësit (bashkëfolësit), kanë dhe një tjetër funksion: atë të të përcaktuarit të një hierarchie marrëdhëniesh midis pjesëtarëve. Kombinimi i këtyre dy varianteve krijon një shumëllojshmëri formash respekti, si p.sh. dallimi formal dhe joformal: p.sh. në italishten midis buongiorno dhe ciao apo midis arrivederLa dhe arrivederci; po edhe në gjuhën shqipe dallimi midis formave sinonime për nga domethënia, por jo identike për nga funksioni e stili: mirëmëngjesi / mgjesi / mjesi / gjesi.

Pika qendrore e këtij kreu përbëhet nga nëndarja e formulave të përshëndetjes në formula përshëndetëse të takimit dhe në formula përshëndetëse të largimit a ndarjes (it. saluti di commiato). Këtu do të evidentohen mospërkimet e para ndërmjet dy gjuhëve, përderisa janë gjuhë të dy popujve dhe dy vendeve, duke e ndarë harkun kohor të ditës në: mëngjes, drekë a mesditë dhe mbrëmje e natë në mënyra të ndryshme, dhe kjo pasqyrohet edhe në përdorimin e përshëndetjeve, qofshin ato të takimit ose të ndarjes a largimit. Në italishten, gjithashtu, parashikohet një përshëndetje e ndarje në vetën e tretë njëjës, pra, duke përdorur në mënyrë eksplicite formën e mirësjelljes, që në shqipen nuk ekziston.

Kreu i tretë u kushtohet tipologjive të ndryshme të urimeve, që ekzistojnë në shqipen dhe në italishten. Midis të gjitha formulave të mirësjelljes, urimet duket se janë ato që pasqyrojnë më shumë se të tjerat zakonet dhe doket e një populli, prandaj janë mbarëse e shprehëse të elementeve kulturore, gjë që dëshmon edhe shkaku pse studimi përmasës (kontrastiv) i tyre është jashtëzakonisht interesant.

Nga ky studim mund të shihet se ekziston gjithmonë një formulë në shqipen, e cila i përgjigjet formulës përkatëse në italishten, ndonëse është e qartë se, ndonjëherë, domethënia leksikore e fjalëve në të dy gjuhët nuk përputhet plotësisht gjatë përkthimit. Sidoqoftë, në shqipen ekzistojnë formula urimi (si për shembull urimi me kafe), që në italishten nuk ekzistojnë dhe kjo, jo pse italishtja është e mangët, por sepse ideja e disa urimeve të shqipes ka të ngjarë se nuk i përket kodit etnografik të italianëve.

Kreu i katërt trajton respektin e shprehur me mjete leksikore. Do të shqyrtohen në mënyrë të përmasur disa nga fjalët, togfjalëshat dhe mjetet e tjera leksikore e fjalëfomueset specifike të mirësjelljes, së pari, në shqipen dhe në vijim e duke bërë edhe përmasjen e nevojshme, në italishten.

Emërtimet e respektit formal janë më të shpeshta në gjuhën e shkruar, por jo vetëm. Dhe në fjalimet politike përdorin epitetet nderuese. Respekti në gjuhë, sipas rasteve mund të jetë krejt fiktiv e formal, porse pikërisht në raste të tilla, mund të ketë edhe format gjuhësore më të epërme dhe të shprehet me epitetet më të larta. Kështu, në rastet letrave e telegrameve zyrtare, që shkëmbejnë kryetarët e shteteve, ambasadorët e vendeve ku janë akredituar etj., janë plot me epitete fikse dhe fraza komplimentuese krejtësisht formale, por edhe të domosdoshme, si: Shkëlqesisë së Tij, zotit x; Madhërisë së tij, Mbretit x; Madhërisë së saj, Mbretëreshës X; Shenjtërisë së Tij, Papa X; Hirësisë së Tij etj. Po kështu edhe në italishten janë të shumta fjalët: emra nderues, tituj dhe graëda dhe mbiemra në shkallën sipërore, drejtuar figurave të caktuara politike, shtetërore, fetare, profesionale, artistike etj., si: Sua Altezza, Sua Eccellenza, Sua Eminenza, Sua Maestà, Sua Santità; epitetet të ndryshme para titullit a gradës, si: chiarissimo (për doktorët, profesorët), magnifico (vetëm për rektorët e universiteteve) etj.

Do të shqyrtohen imtësisht të gjithë titujt nderues (it. titoli onorifici), të përdorur në gjuhën italiane dhe në gjuhën shqipe, duke specifikuar kontekstin e përdorimit të tyre. Në mbështetje të asaj që kemi shprehur teorikisht, do të sjellim edhe shembuj të shumtë të nxjerrë nga letërsia artistike ose nga ligjërimet formale / letra formale reale. Do të shqyrtohen, gjithashtu, në këtë krye edhe epitetet, që përdoren në mjedisin familjar dhe në atë profesional.

Respekti në një gjuhë nuk shfaqet vetëm në leksik dhe drejtshkrim, por shprehet edhe gramatikisht dhe kjo pikë trajtohet në **kreun e pestë**. Në çdo shoqëri apo bashkësi shoqërore ekzistojnë edhe rregulla të caktuara, që “disiplinojnë” marrëdhëniet e njerëzve sipas statusit dhe rolit përkatës. Kjo shprehet sidomos në të drejtuarit me emër apo mbiemër, në të drejtuarit me njëjës ti (përdorim informal) apo në shumës ju (formë respekti) etj. ashtu si përdoret dhe në shqipen. Ka gjuhë që, për të shprehur respektin, përdorin më fort emrin në vetën e tretë njëjës, si italishtja lei, si edhe formën në vetën e dytë shumës voi e vetës së tretë shumës loro. Zgjedhja midis njëjës formë dhe tjetrës varet nga faktorë të ndryshëm sociolinguistikë, si p.sh.: moshë, seksi, situata dhe lloji i lidhjes midis bashkëbiseduesve, pushteti, pasuria dhe rëndësia ose pozita sociale.

Në pjesën e fundit të kreut janë sjellë disa e-mail-e reale, të shkruara nga studentë shqiptarë, me qëllim që të analizojmë e të shohim nëse e kanë rrokur kompetencën e përdorimit të formave të mirësjelljes në italishten sidomos lidhur me format e vetës III njëjës.

Kreu i gjashtë, si mbështetës i krerëve 4 e 5, u kushtohet tërësisht të dhënave të grumbulluara me anën e një pyetësi të titulluar “Respekti formal dhe joformal”, realizuar me anketime në qytetarë shqiptarë. Pyetësi përmban 25 pyetje, që u përkasin situatave në të cilat të

intervistuarit përdorin ti / ju në shqipen ose cilat epitete përdoren në mjedisin familjar, një pyetësor i ideuar dhe i realizuar nga prof. Shkurtaj dhe që është plotësuar nga studentë e studente të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, si detyrë kursi në lëndën e Sociolinguistikës në prill të 2011-s. Të intervistuarit kanë qenë të moshave nga 30 deri 50 vjeç, me seks të ndryshme dhe shkallë arsimore të ndryshme, si edhe që u përkasin qyteteve të ndryshme të Shqipërisë. Gjithsej sasia e të intervistuarve shkon në rreth dyzet.

Mjedisi i fundit i analizës së mirësjelljes analizohet në **kreun e shtatë**. Mbasi kemi analizuar konceptin e mirësjelljes gjuhësore lidhur kryesisht me shkëmbimet verbale, na u duk interesante të shtronim edhe pyetjen, sa therëse aq edhe interesante, mbi vështirësitë që dalin gjatë përkthimit të mirësjelljes nga një tekst i një gjuhe nisëse (it. testo di partenza) në gjuhë të huaj, në një gjuhë mbërritëse. Këtij qëllimi duhej t'i përshtatnim edhe një metodologji, që merr në konsideratë faktin se të përkthesh do të thotë jo thjesht të mbartësh fjalët e një gjuhe në një tjetër, porse të përkthesh edhe mendësitë, doket, zakonet, traditat dhe strategitë e gjuhës/kulturës nisëse (it. lingua/cultura di partenza) në atë të mbërritjes, pa interferenca. Pra, përkthyesit i bie detyra e rëndë: ta kuptojë me themel tekstin, të vendosë lidhjet e kuptimit dhe të individualizojë nyjëtimin logjik të tij, me qëllim që të mund ta riformulojë dhe ta kodifikojë tekstin mbërritës në mënyrë sa më të natyrshme. Përkthyesi, pra, duhet të zotërojë jo vetëm kompetencën gramatikore, por edhe kompetencën tekstore, strategjike, jashtëgjuhësore dhe sociokulturore.

Si shembull kemi zgjedhur librin e Carmine Abate-s *La moto di Scanderbeg*, duke vënë në përqsaje tekstin italisht, në krahasim me përkthimin e tij në gjuhën shqipe.

Me qëllim që të evidentojmë të gjitha shprehjet, që lidhen me përshëndetjet, përemrat vetorë të mirësjellejs, si edhe emrat a apelativat e kortezisë, duke i vënë ata në përqsaje me përkthimin përkatës në gjuhën shqipe. Na u duk interesante të provonim nëse ajo që kemi paraqitur në pjesën hyëse, kryesisht teorike, a ka një përputhje sidomos në gjuhën bashkëkohore, prandaj kemi zgjedhur një vepër letrare të kohëve të fundit, për të vëzhguar pastaj se si shprehjet e lartpërmendura mund të përktheheshin në një gjuhë tjetër, pra, në këtë rast në shqipen.

Kreu i fundit, **i teti**, përbëhet nga një pasqyrë përmbledhëse e të gjitha formulave të përshëndetejeve dhe urimeve, që janë përmendur në punimin e pranishëm. Janë përfshirë, gjithashtu, edhe ato formula, edhe pse nuk bëjnë pjesë në kategorinë e urimeve, që janë përdorur zakonisht në shkëmbimet verbale të përditshme, si format e shfajësimit, të falënderimit, formulat për të ofuar diçka në tryezë, formulat e përdorura në përmbyllje të një pune etj.

E kemi quajtur oportune të përfshijmë në fund edhe një shtojcë, në formën e një fjalorthi shqip-italisht, me të gjithë termat që lidhen me mirësjelljen (emra, tituj nderues, emërtime të farefisnisë etj.), që janë cituar në studimin e pranishëm, me qëllim përmbledhës dhe shpjegues.